




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës (UP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit të Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat që janë në shfrytëzim të UP-së. Këto pasuri përfshinin tri komplekse universitare, dy objekte dhe një parcelë toke. Kjo e kishte nënvlerësuar në vlerë materiale pasurinë e raportuar në PFV-të për vitin 2023, raportin për pasuri kapitale neni 19.3.1. Për shkak të natyrës së çështjes auditori nuk ka arritur të identifikoj vlerën financiare të mos-regjistrimit por gabimi konsiderohet material në aspektin e keq-deklarimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Universitetit të Prishtinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B2 Në dy mostra të ekzaminuara në vlerë totale prej 357,785€ kishte vonesa në pagesën e obligimeve.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Prorektori për buxhet dhe financa është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Prorektori për buxhet dhe financa është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Rektori i Universitetit të Prishtinës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Universitetit të Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Universitetit të Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Universitetit të Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri, ndërsa tre (3) rekomandime janë të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pronave në regjistrin e pasurive kapitale

Gjetja Neni 6 paragrafi 3 i Rregullores nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria", të njëjtat duhet të shpalesen në PFV tek neni 19.

Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat të cilat janë në shfrytëzim të UP-së si në vijim: Objekti dhe parcela e Rektoratit të UP-së, kompleksi Universitar (Objektet e Bibliotekës Kombëtare, Fakulteti Filozofik, Filologjik, Shkencat Natyrore, Edukatës Fizike), kompleksi i Fakultetit Ekonomik, Juridik dhe Edukimit, kompleksi i Fakultetit të Vjetër Teknik (seksioni i arkitekturës), objekti i ri i fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV).

Duhet theksuar se në maj të vitit 2023, Këshilli Drejtues i UP-së kishte emëruar komisionin ndër-institucional për çështje pronësore të UP-së në përbërje prej: zyrtarëve të UP-së, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Pronës nga Komuna e Prishtinës, Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Gjatë vitit 2023 ky komision kishte mbajtur disa takime dhe si fazë fillestare të punës kishte ndërmarrë veprime që kanë të bëjnë me ndarjen e hapësirave të UP-së në zona (kampuse), identifikimin e pronave në shfrytëzim të UP-së, hartimin e skicave për këto parcela si dhe matjen gjeodezike të zonave.

Pavarësisht këtyre veprimeve të ndërmarra deri më tani, gjendja e pasurisë kapitale mbi 1,000€ në fund të vitit 2023 mbetet e pandryshuar.

Kjo çështje është trajtuar në raportet tona tashmë e disa vite me radhë dhe konsiderojmë se gjendja e trashëguar ndër vite është si rezultat i mungesës së veprimeve konkrete të menaxhmentit.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pronave në regjistrin e pasurisë ndikon në prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive në PFV.

Rekomandimi B1 Rektori duhet të ndërmarrë veprime për identifikimin e pronave dhe evidentimin e tyre në regjistrin, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë dhe janë në shfrytëzim të UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV për vitin 2024.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Vonesë në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për PFV të OB, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.

Në dy pagesa për investimet kapitale në vlerë 357,785€, kemi identifikuar se faturat nuk ishin paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin 24 respektivisht 54 ditë pas afatit ligjor për pagesë.

Shkak i vonesave në pagesa të faturave ishte planifikimi jo i mirë i buxhetit.

Ndikimi Mos kryerja e pagesave brenda afatit ligjor, rritë mundësinë që operatorët ekonomik t'i drejtohen përmbauesve apo gjykatave dhe se realizimi i tyre përmes këtyre procedurave mund të krijojë shpenzime shtesë për buxhetin e UP-së.

Rekomandimi B2 Rektori duhet të forcojë kontrollet në fushën e financave për të siguruar se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Në vitin 2023 buxheti final për paga dhe mëditje ishte 18,824,180€, ndërsa realizimi 18,529,985€, apo 98.44%.

Çështja A1 - Tejkallim i afateve në procesin e rekrutimit të punonjësve

Gjetja

Nenet 9,10,11,12 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, përcaktojnë hapat dhe kohëzgjatjen e procesit të rekrutimit. Ku sipas tyre një proces i rekrutimit duhet të përmbyllet diku rreth 128 ditë nga shpallja e konkursit.

Në konkursin e datës 10.06.2022 me numër të referencës 1/325, për rekrutimin/plotësimin e pozitës Zyrtar i lartë financiar, procesi kishte zgjatur më tepër se 12 muaj (nga shpallja e konkursit që ishte bërë me 10.06.2022 deri te rezultati i intervistës që ishte më 22.06.2023).

Zgjatja e procesit të rekrutimit ishte si rezultat i pa përgjegjësisë së zyrtarëve të burimeve njerëzore si dhe kontrolleve të dobëta nga ana e menaxhmentit.

Ndikimi

Tejzgjatja e procedurave të rekrutimit pa arsye mund të ndikoj në performancën e organizatës në përgjithësi si rezultat i mosplotësimin në kohë të vendeve të punës. Si dhe nga pikëpamjet e jashtme, mund të ndikoj në reputacionin e organizatës (UP-së).

Rekomandimi A1

Rektori duhet të sigurohet që procesi i rekrutimit të stafit realizohet brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,819,304€, prej tyre gjatë vitit 2023 ishin shpenzuar 5,527,745€ apo 95%. Këto investime lidhen me renovime dhe ndërtim të objekteve/fakulteteve, furnizime me pajisje të ndryshme laboratorike dhe pajisje të tjera për njësitë akademike.

Çështja B3 - Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave

Gjetja Pika 61 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, sqaron se: Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet nga menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve dhe në pajtim me manualin për përdorim të modulit të vlerësimit të performancës. Si dhe pikat 61.19 (c) dhe 61.20 (f) specifikonë se menaxheri i kontratës për kontratat nën menaxhim të tij siguron që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit kemi identifikuar se nuk është përdorur nga menaxherët e kontratave moduli i e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos kryerjes së punëve me përgjegjësi nga ana e menaxherëve respektivisht mbikëqyrësve të kontratave, përkundër faktit se gjatë vitit 2023 ishte organizuar dhe mbajtur trajnim për përdorimin e modulit në sistem elektronik.

Ndikimi Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve, përveç se është në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik njëkohësisht rrezikon menaxhimin efektiv dhe transparent të kontratave.

Rekomandimi B3 Rektori duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës përdorimin e modulit për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktorëve në sistemin elektronik të prokurimit, duke siguruar menaxhim efektiv dhe transparent të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	32,666,582	32,793,372	30,449,648	29,481,509	28,715,603
Grante Qeveritare - Buxheti	31,466,582	28,929,164	28,338,603	27,858,770	26,337,742
Të bartura nga viti i kaluar	0	345,461	313,797	1,889	574,913
Të hyrat vetanake	1,200,000	1,200,000	962,772	854,539	1,246,382
Donacionet vendore	0	120,991	82,753	39,447	5,573
Donacionet e jashtme	0	2,197,756	751,722	726,865	550,992

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 126,790€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme dhe brendshme në vlerë 2,318,747€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar në vlerë 345,461€, ndërsa nga ana tjetër kemi pasur zvogëlim të buxhetit prej grantit qeveritar në vlerë 2,537,418€.

Në vitin 2023, Universiteti i Prishtinës ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar ose 30,449,648€, me një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	32,666,582	32,793,372	30,449,648	29,481,509	28,715,603
Pagat dhe mëditjet	21,302,582	18,824,181	18,529,985	20,950,106	20,351,336
Mallrat dhe shërbimet	3,150,000	5,637,236	4,330,655	3,919,506	3,622,788
Komunalitë	1,370,000	936,500	697,699	728,887	774,465
Subvencionet dhe transferet	1,444,000	1,576,150	1,363,563	824,924	831,100
Investimet Kapitale	5,400,000	5,819,304	5,527,745	3,058,085	3,135,914

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestare është zvogëluar me vendim të Qeverisë për 2,478,401€, si rezultat i mos plotësimit të të gjitha pozitave të planifikuara. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 98.4%.


• Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestare është rritur për 2,487,236€, kjo rritje vjen nga fondet e donatorëve në vlerë prej 1,885,440€, vendimit të qeverisë për rialokim dhe ridestitim të mjeteve për 577,496€ (kryesisht për mbulimin e pagesave për pastrimin dhe sigurimin e objekteve të UP-së, mirëmbajtja e SEMS), si dhe nga të hyrat e bartura për 24,300€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 76%.

• Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestare kishte zvogëlim për 433,500€, zvogëlimi kishte ndodhur me vendimet e qeverisë për rialokime dhe ridestitime të mjeteve. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 75%.

• Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 132,150€. Lëvizjet buxhetore dhe shpjegimet janë si në vijim: fillimisht ka pas zvogëlim për 202,000€ me vendimet e qeverisë për rialokime dhe ridestitime të mjeteve, pastaj rritje nga të hyrat e bartura nga vitit i kaluar për 320,400€, si dhe nga donacionet me vlerë 13,750€. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 87%.

• Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 419,304€, kjo rritje vjen nga donacionet. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 95%. Këto investime kryesisht kanë të bëjnë me renovime dhe ndërtim të objekteve/fakulteteve si ndërtimi i objektit të FSHMN-së, renovime në objektet e fakultetit teknik, edukimit, arteve etj furnizime me pajisje të ndryshme laboratorike dhe pajisje të tjera për njësitë akademike, ngritja e qendrës për rimëkëmbje për TI-së, si dhe projekte të tjera.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 ishin 2,281,218€ ndërsa realizimi 1,374,654€ . Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga pagesat e studentëve, shitja e shërbimeve (super ekspertizat) nga institutet e njësive akademike dhe shitja e mallrave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	2,281,218	2,281,218	1,374,654	1,530,124	1,493,834
Të hyrat jo tatimore	2,281,218	2,281,218	1,374,654	1,530,124	1,492,249
Të hyrat tjera	0	0			1,585

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të UP-së ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. UP ka përgatitur Planin e Veprimit, ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2023, tre (3) rekomandime janë zbatuar ndërsa tre (3) rekomandime nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Rektori duhet të ndërmerre masa për vlerësimin e pronave dhe evidentimin e tyre në regjistër, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë dhe janë në shfrytëzim të UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV.	Gjendja e njejtë është edhe në vitin 2023. Referenca B1	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rektori duhet të sigurojë që kompensimet e stafit për angazhime shtesë apo punë specifike të paguhen nga kategoria e pagave dhe medijëve. Po ashtu, duhet të hartojë një akt rregullativ për angazhime të stafit administrativ në projektet e donatorëve me të cilin përcakton kriteret e përzgjedhjes dhe procedurën e angazhimit bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e projektit përkatës.	Gjatë testeve të bëra në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2023, nuk kemi hasur në mangësi të tilla.	I zbatuar

3.	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të projekteve, bëhet një analizë e mirëfilltë e natyrës së shpenzimeve dhe ashtu që projektet të buxhetohen në përputhje me natyrën e shpenzimit, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabël.	Gjatë testimeve të bëra në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2023, nuk kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve.	I zbatuar
4.	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë trajnimin e zyrtarëve përgjegjës, në mënyrë që të mundëson aplikimin e modulit përkatës së sistemin e e-prokurimit, për një menaxhim efektiv dhe transparent të kontratave.	Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2023 ishte organizuar trajnimi për zyrtarët lidhur me përdorimin e modulit të e-prokurimit për menaxhimin e kontratave, ky modul nuk kishte aplikuar as gjatë vitit 2023. Referenca B2	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Pasuritë	Rektori duhet të duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-Pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu duhet të sigurojë se harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, bëhet para përgatitjes së PFV-ve.	Gjatë vitit 2023 është funksionalizuar sistemi e-pasuria.	I zbatuar
6.	Obligimet e papaguara	Rektori duhet të sigurojë se të gjitha obligimet/faturat të paguhen brenda afatit prej 30 ditëve pas pranimit të faturave.	Raste të ngjashme përsëriten edhe gjatë vitit 2023. Referenca B3	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Flora Berisha, Udhëheqëse e ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11530
Datë: 16.5.2024

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- **Pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Besmir Krasniqi
Sekretar i përgjithshëm i UP-së
Data: 16.5.2024

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.